



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 prill 2021
Nr.ref.:RK 1755/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI68/20

Parashtrues

Hysen Thaqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës Rev.nr.383/2019 të 14 janarit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hysen Thaqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Afrim Krasniqi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Rev.nr.383/2019] të 14 janarit 2020 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [4470/2016] të 4 korrikut 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 prill 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 8 qershor 2020, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe atij iu kërkuar që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës në Gjykatë.
8. Më 12 qershor 2020, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi autorizimin nga parashtruesi i kërkesës lidhur me kërkesën nr. KI68/20.
9. Më 10 gusht 2020, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
10. Më 5 janar 2021, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzon dokument që provon datën e dorëzimit të kërkesës për dëmshpërblim material dhe jomaterial.
11. Më 11 janar 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentin e lartpërmendur.
12. Më 29 mars 2021, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Nga dokumentet e dorëzuara rezulton se më 16 nëntor 2008 në rrugën Prishtinë-Podujevë në fshatin Prugovc, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në mes të automjeteve të markës “Audi 89” të drejtuar nga parashtruesi i kërkesës dhe automjetit të markës “Volkswagen Kombi” të drejtuar nga personi FH dhe si pasojë e këtij aksidenti lëndime trupore kanë pësuar drejtuesit e të dy automjeteve dhe tre bashkudhëtar të parashtruesit të kërkesës. Përveç këtyre automjeteve në këtë aksident ka qenë i përfshirë edhe automjeti i markës “VW Golf” me ngjyrë të bardhë që ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit por që nuk ishte identifikuar.
14. Më 4 mars 2009, Prokurori Publik në Prishtinë me propozimin akuzues PP.nr.8-11/09 kishte pohuar se parashtruesi i kërkesës kishte kryer veprën penale nga neni 297 (1) dhe (3) [Rrezikimi i Trafikut Publik] të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, UNMIK/RREG/2003/25 (në tekstin e mëtejme: KPK). Prokurori Publik po ashtu kishte pohuar se bazuar në ekspertizat e komunikacionit, mjekësisë ligjore dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe duke marrë parasysh rrezikshmërinë shoqërore dhe peshën e veprës penale, parashtruesi i kërkesës duhet të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim “adekuat”.
15. Më 13 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykim [P.nr.502/09] e liroi parashtruesin e kërkesës nga akuza e lartpërmendur e paraqitur nga Prokurori Publik në Prishtinë. Gjykata Komunale kishte vlerësuar: (i) se me provat e nxjerra nga shqyrtimi gjyqësor në tërësi nuk është vërtetuar se i pandehuri (parashtruesi i kërkesës) ka kryer veprën penale që i vihet barrë nga Prokurori Publik; (ii) nuk është vërtetuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 (1) dhe (3) i KPK-së dhe se për këtë arsye është liruar nga akuza bazuar në nenin 390 paragrafi 1 dhe nën-paragrafi (3) [pa titull] i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës UNMIK/RREG/2003/26 (në tekstin e mëtejme: KPPK); dhe (iii) bazuar në nenin 112.2 të KPPK-së lidhur me kërkesat pasurore-juridike udhëzoi të dëmtuarit në kontest civil.
16. Më 17 janar 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për kompensim të dëmit në kompaninë e sigurimeve “SIGMA” me seli në Prishtinë duke kërkuar që të pranohet kërkesa për “shpagim” të dëmit material dhe jo material të pësuar në aksidentin e 16 nëntorit 2011.
17. Më 18 janar 2012, parashtruesi i kërkesës kishte paditur Byronë Kosovare të Sigurimeve në Gjykatën Themelore në Prishtinë për kompensimin e dëmit material dhe jo material lidhur me lëndimet trupore dhe dëmtimit të automjetit. Më 11 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës kishte precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar kompensimin e dëmit: (i) në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 20,000.00 €; (ii) në emër të frikës shumë prej 15,000.00 €; (iii) në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor shumë prej 27,000.00 € ; (iv) në emër të aktivitetit të përgjithshëm punues në formë të kapitalizuar shumë prej 30,398.07 €; (v) në emër të ndihmës së personit të tretë shumë prej 700.00 €; (vi) në emër të rehabilitimit klimaterik shumë prej

800.00 €; (vii) në emër shpenzimeve mjekësore prej 702.00 €; si dhe, (viii) në emër të dëmtimit material të automjetit të aksidentuar shumë prej 980.00 €.

18. Pala e paditur kishte kundërshtuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës duke theksuar: (i) se provat e paraqitura nuk janë bazë juridike për pranimin e përgjegjesisë për dëmshpërblim; (ii) seanca duhet të shtyhet deri në zgjidhjen e çështjes lidhur me fajësinë-kontributin eventuale të pjesëmarrësve në aksident; (iii) nuk është vërtetuar legjitimiteti pasiv i palës së paditur; dhe, (iv) kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar.
19. Më 20 korrik 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykim [C.nr.118/12] miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës duke përcaktuar: (i) detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit t'ia kompensojë shumë prej 54.201,37 € në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit-nën kërcënim të përmbarimit; (ii) detyrohet e paditura që në emër të dëmit të shkaktuar në automjetin e markës "Audi 89", paditësit (parashtruesit të kërkesës) t'ia paguaj shumë prej 980,00 € si dhe në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj 2,173.59 € në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit; si dhe (iii) refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës përtej shumës së gjykuar për kompensimin e dëmit jo material për shkak të dhimbjeve fizike në shumë prej 10,000.00 €, për shkak të frikës së përjetuar shumë prej 8,000.00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 5,000.00 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 100.00 €, për kujdesin e huaj shumë prej 200.00 €, për rehabilitim klimaterik 800.00 €, për shpenzimet mjekësore shumë prej 720.00 €.
20. Gjykata Themelore kishte arsyetuar: (i) se nga provat e nxjerra mund të përfundohet se në aksidentin e komunikacionit të shkaktuar më dt.16.11.2008, parashtruesi i kërkesës ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe me pasoja që i janë shkaktuar nga vozitësi i automjetit të paidentifikuar; (ii) kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës gjen mbështetje ligjore në nenin 20 [Dëmshpërblimi nga përdorimi i mjeteve të paidentifikuara] të Ligjit 04/L-18 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Byroja Kosovare e Sigurimeve është e obliguar ta paguaj dëmin e shkaktuar nga mjeti motorik i paidentifikuar; (iii) nga ekspertiza e ekspertëve mjekësorë vërtetohet se parashtruesi i kërkesës ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 35% dhe zvogëlim të aftësisë punuese në shkallë prej 40%; (iv) pretendimi i palës së paditur se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar refuzohet i pabazuar, sepse parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesëpadinë më dt. 18.11.2012, vetëm disa muaj pas aktgjykimit penal të plotfuqishëm P.nr.502/09, prandaj në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim; dhe, (v) kompensimi për dëmin material dhe jo material u përcaktua duke u mbështetur në rrethanat faktike të rastit konkret, provat e nxjerra dhe në dispozitat e neneve 154 [Bazat e përgjegjesisë], 178 [Përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga automjetet në lëvizje] dhe 200 [Kompensimi në të holla] të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të 30 marsit 1978 (në tekstin e mëtejshëm: LMD i vjetër).
21. Më 11 tetor 2016, pala e paditur paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të

dispozitave të Ligjit Nr.03/L-006 të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim që ankesa të miratohet e bazuar dhe aktgjykimi i goditur të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallën e parë.

22. Më 4 korrik 2019, Gjykata e Apelit me Aktgjykim [Ac.nr.4470/16] përcaktoi: (i) aprovohet pjesërisht ankesa e palës së paditur Byroja Kosovare e Sigurimit; (ii) ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [C.nr.118/12] i 20 korrikut 2016, në pjesën sa i përket dhimbjeve fizike, frikës dhe për zvogëlimin e përgjithshëm të aktivitetit jetësor, për paditësin Hysen Thaqi (parashtruesi i kërkesës) dhe gjykohet (iii) detyrohet Byroja Kosovare e Sigurimeve që në emër të kompensimit të dëmit jo material, parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë për dhimbje fizike shumë prej 7,000.00 €, për frikën shumë prej 5,500.00 €, dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 18,000.00 euro; (iv) sa i përket pjesës tjetër të dispozitivit ankesa e të paditurës refuzohet e pathemeltë ndërsa aktgjykimi i goditur vërtetohet; (v) priset Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [C.nr.118/12] i 20 korrikut 2016, sa i përket rentës, dhe për këtë pjesë çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.
23. Gjykata e Apelit kishte arsyetuar: (i) pretendimi i palës së paditur për shkelje esenciale të dispozitave procedurale nuk qëndron sepse gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore; (ii) gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejtë kriteret që në rastin konkret ndikojnë që parashtruesit të kërkesës t'i caktohet shpërblimi në të holla i barasvlershëm me shkallën dhe pasojat e të mirës së cenuar dhe shkallën e kontributit të vetë parashtruesit të kërkesës në shkaktimin e aksidentit; (iii) bazuar në nenin 376 [Kërkesa e shpërblimit të dëmit] të LMD-së vjetër kërkesëpadia parashtruesit të kërkesës nuk është parashkruar; (iv) është prishur pika I e dispozitivit të gjykatës së shkallës së parë, për pjesën që ka të bëjë me rentën, sepse nuk është marrë mendimi i ekspertit të punës që është qenësor për përcaktimin e zvogëlimit të aktivitetit punues si dhe caktimit të rentës.
24. Më 30 korrik 2019, pala e paditur paraqiti revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ose të njëjtat të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
25. Më 6 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen në drejtim të rritjes së shumave të gjykuara.
26. Më 14 janar 2020, Gjykata Supreme me Aktgjykim [Rev. nr.383/2019] vendosi: (i) pranohet i bazuar revizioni i të paditurit, ndryshohen Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AC.nr.4470/2016 i 4 korrikut 2019 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore C.nr.118/12 të 20 korrikut 2016, ashtu që refuzohet kërkesëpadia e

parashtruesit të kërkesës që e paditura në emër të dëmit jo material të paguajë për dhimbje fizike të pësuar shumën prej 7,000.00 €, për shkak frikës së pësuar shumën prej 5,500 € dhe në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 18,000.00 € dhe në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar shumën prej 400 €, për kujdesin e personit të tretë shumën prej 500 € si dhe në emër të dëmit material të shkaktuar në automjetin e parashtruesit të kërkesës me kamatën që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë si kërkesë e pabazuar; (ii) refuzohet revizioni i parashtruesit të kërkesës i pabazuar.

27. Gjykata Supreme kishte arsyetuar: (i) se nuk mund ta pranojë si të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët sipas të cilit pala e paditur detyrohet që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë shumat e gjykuara në emër të dëmit material dhe jo material, sepse aktgjykimet e kontestuar janë karakterizuar me zbatim të gabuar të së drejtës materiale; (ii) kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar dhe se sipas nenit 376.1 të LMD-së vjetër është përcaktuar se kërkesa për shpërblim të dëmit parashkruhet në afat prej tre vjetësh nga dita kur i dëmtuari ka qenë në dijeni për dëmin dhe personin që ka shkaktuar dëmin; (iii) parashtruesi i kërkesës ka qenë në dijeni nga çasti kur ka marrë raportin e aksidentit nga policia me numër të rastit 08AR nr. 02374 të 16 nëntorit 2008; (iv) parashtruesi i kërkesës në këtë çështje juridike ka paraqitur padinë më 18 janar 2012, pas afatit ligjor të parashikuar me dispozitën e nenit 376.1 të LMD-së së vjetër; dhe se, (v) në rastin konkret nuk mund të zbatohet afati objektiv nga neni 376.2 dhe as parashkrimi i privilegjuar nga neni 377 i LMD-së së vjetër.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Paditësi nëpërmes të autorizuarit të tij konsideron se Gjykata Supreme e Kosovës gjatë procedurës së zhvilluar lidhur me revizionin e të paditurës ka bërë shkelje të drejtës së garantuar me nenin 3.2 të Kushtetutës ku kjo e drejtë bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht [...] ka shkel nenin 31 të Kushtetutës ku çdokujt mbrojtje e veçantë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore, bartësve të kompetencave publike, nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [...] shkelja e të drejtës në kompensim material dhe jo material të paditësit nga ana e Gjykatës Supreme e Kosovës si e drejtë themelore [...]”*
30. Lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë së tij, parashtruesi i kërkesës pohon: *“Gjykata Supreme në arsyetimin e paraqitur ndër të tjera paraqet arsye të cilat janë plotësisht në kundërtënie me provat materiale sepse padia e paditësit në rastin konkret është paraqit brenda afatit ligjor pra me dt.16.01.2012 dhe atë pasi që paditësi e ka marr aktgjykimin penal të dt.13.12.2011 i cili është i*

plotfuqishëm dhe me të cilin paditësi në rastin konkret i pandehuri LIROHET NGA AKUZA, dhe me të cilin aktgjykim udhëzohet që kontestin civil ta realizoj në procedurë civile. Paditësi më herët nuk ka mundur të paraqes padi për kompensim nga fakti se ai veç është akuzuar për vepër penale rrezikim i trafikut publik.”

31. Parashtruesi i kërkesës pohon se kërkesëpadinë e ka paraqitur në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore që përcaktojnë se në rast të lëndimit trupor apo dëmtimit shëndetësor, të shkaktuar nga automjeti i paidentifikuar barra e kompensimit bie mbi Byronë Kosovare të Sigurimit.
32. Parashtruesi i kërkesës kërkon aktgjykimin e kontestuar i Gjykatës Supreme të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim për shkak të shkeljes të së drejtës për kompensim material dhe jo material.

Dispozitat relevante ligjore

Ligjit 04/L-18 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia

Neni 20

Dëmshpërblimi nga përdorimi i mjeteve të paidentifikuara

- 1. Personi fizik i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi nga përdorimi i mjetit motorik të paidentifikuar, ka të drejtë të parashtrojë kërkesën për dëmshpërblim Byrosë.*
- 2. Personi fizik i dëmtuar ka të drejtë dëmshpërblimi për dëmet që vijnë si rezultat i vdekjes, dëmtimeve trupore apo përkeqësimit të shëndetit deri në shumën e përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji.*
- 3. I dëmtuari ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për dëmet në sende, duke përjashtuar dëmet në mjete motorike, të shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik të paidentifikuar, deri në shumën e përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji.*
- 4. I dëmtuari ka për detyrim që dëmin e shkaktuar nga mjeti motorik i paidentifikuar, t'ia raportojë policisë së trafikut rrugor, në afat prej shtatë (7) ditësh në rast të dëmit në pasuri dhe në afat prej tridhjetë (30) ditësh në rast të dëmit në persona nga dita e aksidentit. I dëmtuari gjithashtu ka për detyrim të paraqes rastin në Byro në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh.*
- 5. Në rast të identifikimit të mëvonshëm të mjetit shkaktar të aksidentit, apo të siguruesit përgjegjës, Byroja ka të drejtë regresi nga personi përgjegjës ose siguruesi përgjegjës për shumën e paguar të dëmit, shpenzimet dhe kamatat.*

Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë e Bankës Qendrore të Kosovës e miratuar më 25 shtator 2008

Neni 4

Fondi Garantues

4.1 Dispozitat e Përgjithshme

Fondi garantues duhet të formohet nga kontributet e paguara prej kompanive të sigurimit ne pajtim me këtë rregull. Paratë apo mjetet financiare qe përbëjnë këtë fond garantues duhet te depozitohen dhe mbahen në një bankë komerciale te licencuar nga BQK-ja.

Mjetet nga fondi garantues do të përdoren për pagesën e dëmeve të shkaktuara:

[...]

c. Në rast vdekje, lëndimi trupor apo dëmtimi shëndetësor, të shkaktuar nga përdorimi i automjetit të paidentifikuar.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të 30 marsit 1978

Neni 154

Bazat e përgjegjësisë

Kush i shkaktton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.

Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga faji.

Për dëmin pavarësisht nga faji përgjigjet edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Neni 178

Përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga automjetet në lëvizje

Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesiseduesi të automjetit vihen në zbatim regullate mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë.

Në qoftë se ekziston faji dypalësh, secili zotërues përgjigjet për dëmin total që e kanë pësuar ata përpjestimisht me shkallën e fajësisë së tyre.

Në qoftë se nuk ka fajsi në asnjë anë zotëruesit përgjigjen në pjesë të barabarta në qoftë se shkaqet e drejtërisë nuk kërkojnë gjë tjetër.

Për dëmin që e kanë pësuar personat e tretë zotëruesit e automjeteve përgjigjen solidarisht.

Neni 200

Kompensimi në të holla

Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material.

Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Neni 376

Kërkesa e shpërblimit të dëmit

Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet prë tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin.

Sidoçoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi.

Kërkesa e shpërblimit të dëmit të krijuar nga cenimi i detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e këtij detyrimi.

Neni 377

Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga vepra penale

Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.

Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale passjell edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit.

E njëjta gjë vlen edhe për ngecjen e parashkrimit.

**Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës
UNMIK/RREG/2003/26**

Neni 112

(1) Për kërkesat pasurore juridike vendos gjykata.

(2) Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim

të plotë e as të pjesërishëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në një kontest civil.

(3) Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilën akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil. Kur gjykata shpallet jokompetente për procedurën penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta ushtrojë në procedurë penale të filluar ose të vazhduar nga gjykata kompetente.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

35. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

36. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtguesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme me [Rev. nr.383/2019] të 14 janarit 2020, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

37. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtguesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

38. Gjykata rikujton që parashtguesi i kërkesës ishte akuzuar nga Prokurori Publik nën akuzën se ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik të KPK-së por që më vonë Gjykata Komunale në Prishtinë kishte liruar atë nga akuza që e rëndonte Prokurori Publik. Më pas, parashtguesi i kërkesës kishte paditur Byronë Kosovare të Sigurimeve për dëmshpërblim material dhe jo material. Gjykata Themelore kishte miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtguesit të kërkesës dhe i kishte akorduar dëmshpërblim në shuma të caktuara për dëmin e pësuar. Ndërkohë, pala e paditur Byroja Kosovare e Sigurimit paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar, mes tjerash, se kërkesëpadia e parashtguesit të kërkesës ishte parashkruar. Gjykata e Apelit e aprovoi pjesërisht ankesën e Byrosë Kosovare të Sigurimit lidhur me dhimbjet fizike, zvogëlimin e përgjithshëm të aktivitetit jetësor të parashtguesit të kërkesës dhe rentën. Pas revizionit të paraqitur nga parashtguesi i kërkesës dhe pala e paditur Byroja Kosovare e Sigurimit, Gjykata Supreme vendosi që të pranohet i bazuar revizioni i palës së paditurit Byroja Kosovare e Sigurimit, të ndryshohen vendimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe të refuzohet kërkesëpadia e parashtguesit të kërkesës për kompensim për dëmin e pësuar.

39. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtguesit të kërkesës është se Gjykata Supreme gabimisht ka vlerësuar provat materiale sepse ai në pajtim me afatin ligjor ka paraqitur kërkesën për dëmshpërblim. Parashtguesi i kërkesës shton se ai nuk ka mundur të paraqesë kërkesë për dëmshpërblim para se të lirohej nga akuza me aktgjykim lirues të Gjykatës Themelore dhe për këtë arsye janë shkelur

të drejtat e tij të garantuara me nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

40. Gjykata në vijim, do të trajtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
41. Në këtë drejtim Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte konstatuar: (i) se nuk mund ta pranojë si të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët sipas të cilit pala e paditur detyrohet që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë shumat e gjykuara në emër të dëmit material dhe jo material, sepse aktgjykimet e kontestuara janë karakterizuar me zbatim të gabuar të së drejtës materiale; (ii) kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar dhe se sipas nenit 376.1 të LMD-së vjetër është përcaktuar se kërkesa për shpërblim të dëmit parashkruhet në afat prej tre vjetësh nga dita kur i dëmtuari ka qenë në dijeni për dëmin dhe personin që ka shkaktuar dëmin; (iii) parashtruesi i kërkesës ka qenë në dijeni nga çasti kur ka marrë raportin e aksidentit nga policia me numër të rastit 08AR nr. 02374 të 16 nëntorit 2008; (iv) parashtruesi i kërkesës në këtë çështje juridike ka paraqitur padinë më 18 janar 2012, pas afatit ligjor të parashikuar me dispozitën e nenit 376.1 të LMD-së së vjetër; dhe se, (v) në rastin konkret nuk mund të zbatohet afati objektiv nga neni 376.2 dhe as parashkrimi i privilegjuar nga neni 377 i LMD-së së vjetër.
42. Në këtë drejtim, Gjykata vë në spikamë pjesët relevante të aktgjykimit të Gjykatës Supreme:

“Kërkesa e paditësit është parashkruar dhe se sipas nenit 376.1 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, është përcaktuar se parashkrimi i kërkesës për shpërblim të dëmit parashkruhet në afat prej tre vjet nga data kur i dëmtuari ka marrë dijen për dëmin dhe për personin, i cili ka shkaktuar dëmin, në këtë rast kemi të bëjmë me afat subjektiv. Për zbatimin e afatit subjektiv të parashkrimit duhet të plotësohen dy kushte subjektive, se dëmi është shkaktuar dhe se paditësi ka ditur për dëmin e shkaktuar dhe për personin që ka shkaktuar dëmin, paditësi ka ditur nga momenti kur ka marrë raportin e aksidentit nga policia si dhe nga raporti shtesë të Policisë së Kosovës-Njësitit të Trafikut Regjional- Prishtinë me nr. të rastit 08AR nr. 02374 të datës 16.11.2008. Padia e paraqitur me datën 18.11.2012 në këtë çështje juridike është pas afatit ligjor sipas dispozitës së nenit 376.1 të LMD-së. Në rastin konkret nuk mund të zbatohet afati objektiv nga neni 376.2 të LMD si dhe parashkrimi i privilegjuar nga neni 377 të LMD.”

43. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka qenë në dijeni për të drejtën për dëmshpërblim nga çasti kur ka marrë raportin e aksidentit nga Policia e Kosovës me numër të rastit 08AR nr. 02374 të 16 nëntorit 2008. Parashtruesi i kërkesës më 17 janar 2012 ka paraqitur kërkesë për dëmshpërblim tek kompania e sigurimeve “SIGMA” në Prishtinë e pastaj, një ditë më vonë më 18 janar 2012, ka paditur Byronë Kosovare të Sigurimit në Gjykatën Themelore duke kërkuar

dëmshpërblim, çka Gjykata Supreme e ka cilësuar jashtë afatit ligjor prej tre (3) vjetësh të paraparë me nenin 376.1 të LMD-së së vjetër.

44. Gjykata vëren se në rastin konkret kemi të bëjmë me vlerësim të ndryshëm të afatit ligjor për parashtrim të kërkesëpadisë për dëmshpërblim me ç ‘rast në njërën anë, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë gjykuar se afati ligjor rrjedhë nga dita e aktgjykimit lirues kurse Gjykata Supreme ka gjykuar se afati ligjor për kërkesë për dëmshpërblim rrjedhë nga dita kur parashtruesi i kërkesës ka qenë në dijeni për aksidentin, në anën tjetër.
45. Gjykata thekson se sa i përket gjyqësorit të rregullt, Gjykata Supreme është autoriteti më lartë gjyqësor në Republikën e Kosovës (shih nenin 103.2 të Kushtetutës) dhe se interpretimi i saj i afateve ligjore por edhe çështjeve tjera të ligjit mbizotëron ndaj interpretimeve ligjore të Gjykatave Themelore dhe Gjykatës së Apelit.
46. Nga sa më sipër, Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 qershorit 2018, paragrafi 57).
47. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikë gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 38; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58).
48. Gjykata më tej rithekson se, në parim, interpretimi i ligjit është kompetencë e gjykatave të rregullta. Për më tepër, “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës nr. KI42/16 Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).

49. Gjykata gjithashtu thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe KI142/15, *Parashtrues Habib Makiqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
50. Gjykata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta vetvetiu nuk ngre pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (shih rastin e Gjykatës nr. KI118/18 *Parashtrues Eco Construction sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe po ashtu shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe, ndër të tjera, KI56/17, cituar më lart, paragrafi 42).
51. Nga sa më sipër, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
52. Në fund, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 3 dhe 46 të Kushtetutës, mirëpo pa argumentuar se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me këto nene. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21.; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
53. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 29 mars 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi